



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrimit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 51/2024
Datë: 23.04.2024

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, bazuar në Rregulloren (QRK) NR.14/2023 Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 2157/2024 i datës 23.04.2024 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme të Aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë të cilat mund të jenë pjesë përbërëse potenciale të Trashëgimisë Kulturorë (në tekstin e mëtejshëm Komisioni Profesional Shqyrtues).
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 2157/2024 i datës 23.04.2024 për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme të asetit “**Opusi i shoqërive kulturore të komunitetit turk në Prizren**” në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturorë shpirtërore, e parashtuar nga QRK - Prizren pranë Komisionit Profesional shqyrtues (KPSH) i Muzeut Kombëtar të Kosovës (MKK) me propozimin “Potpuri vallesh nga komuniteti turk në Prizren”.

KPSH në MKK ka dhënë rekomandimin që **“Opusi i shoqërive kulturore të komunitetit turk në Prizren”** (me numër unik në databazë: 04915) të përfshihet në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme në Kategorinë e Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK-s pas shqyrtimit të lëndës, formulari i inventarizimit të punuar nga KPSH i MKK dhe rekomandimit të tij, e rekomandon për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme **“Opusi i shoqërive kulturore të komunitetit turk në Prizren”** në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore me përshkrim të elementit/njësisë:

Artet skenike - përfshin performimin e valleve në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare.

Praktikat sociale, ritualet dhe ngjarjet festive – përfshin performimin e valleve në ahengje familjare, dasma, fejesa, syneti etj.

Mjeshtëritë tradicionale - përfshin kostumet të cilat janë të punuara me dorë me materiale të pëlhurës të qëndisura me fije ari – argjendi dhe me llojlojshmëri ngjyrash.

“Opusi i shoqërive kulturore të komunitetit turk në Prizren” në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore, rekomandohet për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme për arsye se i përmban këto vlera:

Vlerat Historike:

Dëshmon për vijimësinë e pasurisë shpirtërore të komunitetit Turk në Prizren por edhe më gjerë për ta përcjellë ndërlidhjen me të kaluarën si perceptim të domethënies së trashëgimisë kulturore.

Vlerat Shoqërore:

Shpreh formën e kujtesës dhe shoqërimit shpirtëror. Dëshmon për transmetimin me gjenerata për të shprehur ndjenjën e bashkëjetesës, identitetit, vazhdimësisë dhe diversitetit kulturor. Inkurajon ndjenjën e identitetit dhe përgjegjësisë e cila e inspiron komunitetin Turk në Prizren dhe më gjerë të ndihet si pjesë e shoqërisë në përgjithësi;

Janë trashëguar brez pas brezi, kanë evoluar në varësi nga mjediset e tyre duke siguruar një lidhje nga e kaluara, përmes së tashmes dhe për të ardhmen.

Përfshin performimin e valleve në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka rëndësi dhe shpreh vlera artistike me performimin e valleve, të komunitetit Turk, si arte skenike si dhe kostumeve tradicionale të punuara me dorë. Dëshmon ruajtjen dhe promovimin e vlerave Artistike përmes artit skenik dhe performimit të llojeve të valleve të ndryshme si: **Mevlana Oyon** (valle fetare), **Horo I dhe II** (I - valle e burrave, II - valle e vajzave), **Kilic oyunlari** (vallja e shpatave), **Aynali pembe** (Ajnallë pembe), **Celin Yani Oyon** (vallja e nuses), **Kaçamak oyunlari** (vallja e kaçamakut), **Bardak Oyon** (vallja e gotave).

Vlerat Shkencore/Edukative:

Ofron lidhje me të kaluarën. Ofron mundësi të studimit të ndryshimeve të zakoneve dhe shprehjeve artistike gjatë dekadave dhe lidhjen me ndryshimet, transformimet dhe zhvillimet në mjedis dhe shoqëri. Mundëson ruajtjen e origjinalitetit dhe praktikimit të valleve deri në ditët e sotme të në ceremoni, ahengje familjare, festa tradicionale të komunitetit turk, festivale të praktikuara në Prizren, Kosovë, përfaqësim në Tyrkije.

Vlerat Ekonomike dhe të Trashëgimisë:

Shpreh dëshirën për të lënë traditë dhe pasuri shpirtërore në trashëgimi për breza të ardhshëm. Promovon vlera kulturore të komunitetit Turk në Prizren por edhe në viset tjera të Kosovës, e posaçërisht diversitetin kulturor dhe bashkëjetesën. Promovon turizëm kulturor duke promovuar arte skenike dhe diversitet kulturor me performime në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Ruan dhe zhvillon mjeshtëri tradicionale në llojlojshmërinë e kostumeve të punuara me dorë. Mbajtja e festivaleve i ka përfitimet ekonomike, zhvillimin e bizneseve të vogla etj.

Andaj, nga kjo që u tha si në dispozitivin e këtij vendimi, aseti **“Opusi i shoqërive kulturore të komunitetit turk në Prizren”** në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore, rekomandohet për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme.

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Komisionit Shqyrtues;*
- *Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;*
- *QRTK – Prizren;*
- *Muzeut Kombëtar të Kosovës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MKRS-së.*

